

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dip. Dep.	DPK
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	03-03/2506/20
Nr. Kllau Proj. Stranica Nr. gogjet	03
Data Datum Date	05.11.2020
PS/SMTINE	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	04.11.2020
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-2302/20
PËR/ZA/TO:	z. Marjan PERLASKA, Menaxher i Prokurimi në Agjencinë Kosovare të Privatizimit
CC:	z. Valon TOLAJ, Drejtor Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Inventarizimi i Objektivit të ri të AKP-së"

I nderuar z. Perlaska,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **"Inventarizimi i Objektivit të ri të AKP-së"**, me numër të prokurimit: 239/20/6076/121 dhe me nr. të brendshëm: 239/20/025/121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **"Inventarizimi i Objektivit të ri të AKP-së"**, me numër të prokurimit: 239/20/6076/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 26 tetor 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03/2302/20, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: **“Inventarizimi i Objektivit të ri të AKP-së”**, me numër të prokurimit: 239/20/6076/121 dhe me nr. të brendshëm: 239/20/025/121, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike, të llojit furnizim, me vlerë të mesme të parashikuar 153,000.00 €.

Në kuadër të rubrikës III.2.4. Kapaciteti teknike dhe profesionale kërkesa 1, Agjencia vëren se, Autoriteti kontraktues **ka kërkuar nga operatorët ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë dëshmi për së paku 3 projekte të realizuara të furnizimeve relevante (më një fushëveprim të ngjashëm të furnizimeve) të realizuara në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej jo më pak se 150,000.00€** Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 2.1 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

Agjencia konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të projekteve në vlerën e caktuar. E rëndësishme për autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të projekteve. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i projekteve në vlerë të caktuar.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Agjencia kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminimi, si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

